



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:264985

Datë: 03.06.2024

Numri i dokumentit: 05769317

KPPP.nr. 2056/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Florent Zeqiri, në çështjen përbarimore të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.A, me numër të regjistrimit të biznesit 70465104 dhe me seli në Mitrovicë, rr. “V.Dragaj”, p.n., kundër debitorit “Korabi Show-2” Sh.P.K., me numër unik identifikues 810689375 dhe me seli në Vushtrri, rr. “Nexhip & Ferat Dragaj”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 1520/23 të datës 25.10.2023, të lejuar nga Përbaruesi Privat Atip Mustafa me seli të zyrës në Mitrovicë, jashtë seancës, me datë 03.06.2024 merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET në tërësi si i bazuar prapësimi i debitorit “Korabi Show-2” Sh.P.K., ndërsa Urdhri Përbarimor P.nr. 1520/23 i datës 25.10.2023, i lejuar nga Përbaruesi Privat Atip Mustafa, ANULOHET.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Regjionale e Mbeturinave “Uniteti” Sh.A, me datë 25.10.2023 ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr. 1520/23 me të cilin ka lejuar përbarimin në bazë të dokumentit Ekstraktit të verifikuar nga librat afarist VU.5.B.191304, ashtu që është detyruar debitori që në afat prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhrin, t’ia paguaj kreditorit detyrimin në vlerë prej 551.00 EUR, me kamatë ligjore prej 8 %, duke e llogaritur nga data e paraqitjes së propozimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të këtij propozimi.

Debitori, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor nuk është dokument i besueshëm dhe i përshtatshëm për përmbartim. Më tej, ka theksuar se propozimi për përmbartim është adresuar gabimisht pasi që subjekti ekonomik i ngarkuar me vlerën e pretenduar asnjëherë nuk ka pasur veprimtari ekonomike në adresën dhe objektin e cekur në propozim. Duke qenë se dokumenti nuk është pranuar nga debitori, nuk është nënshkruar dhe vulosur nga i njëjti, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit, ndërsa urdhri përmbartimor të shfuqizohet.

Kreditori, në përgjigje ndaj prapësimin ka kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim me arsyetim se dokumenti në bazë të së cilit është lejuar urdhri përmbartimor i përmban të gjitha të dhënat e sakta lidhur me debitorin, të dhënat e borxhit, si dhe datën për secilën faturë veç e veç. Ka shtuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit se nuk ka zhvilluar asnjëherë aktivitetin afarist në adresën si në propozimin për përmbartim, për faktin se i njëjti ka kryer pagesa kohë pas kohe në emër të borxhit në fjalë. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të mbetet në fuqi.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të LPP-së, si dokumente të besueshme listohen *“ekstraktet e verifikuara nga librat afariste për pagesat e shërbimeve komunale të furnizimit me ujë, energji elektrike dhe bartjen e mbeturinave”* ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*.

Në rastin konkret gjykata gjen se dokumenti Ekstrakti i verifikuar nga librat afarist librat afarist VU.5.B.191304 mbi e të cilit përmbartuesi privat ka lejuar përmbartimin, nuk i plotëson kushtet që të qenë dokument i besueshëm për shkak se nuk i përmban elementet e kërkuara me nenin 29,

par.3 të LPP-së, konkretisht nga ky ekstrakt nuk përcaktohet në mënyrë të qartë objekti i detyrimit si dhe periudha kohore për të cilën kërkohet përmbushja e detyrimit.

Deri tek ky përfundim gjykata erdhi pasi që në hyrje të propozimit për përmbarim, kreditori nuk ka përcaktuar fare periudhën kohore për të cilën kërkohet realizimi i borxhit ndaj debitorit. Ndërsa në përmbajtjen e këtij ekstrakti nga librat afarist, për periudhën 01.01.2018 e deri më 31.12.2018, figuron borxh i bartur në vlerë prej 568.40 EUR, por që kjo lartësi e borxhit nuk dihet se për cilën periudhë kohore është grumbulluar, pasi që propozimit për përmbarim nuk i janë bashkangjitur ekstraktet që përmbajnë faturat edhe për këtë pjesë të borxhit.

Prandaj, në formën e paraqitur, ekstrakti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk pasqyron qartë detyrimin që rrjedh nga i njëjti dhe rrjedhimisht nuk përmban atributet e një dokumenti të besueshëm.

Meqenëse dokumenti mbi bazën e të cilit është lejuar përmbarimi nuk ka tipare të përmbarueshmërisë për shkak të të metave në objektin e detyrimit të saj, gjykata nuk u lëshua në vlerësimin e pretendimeve të tjera të ngritura nga debitori si në prapësim, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit vendosi jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73, par.3 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 2056/23, datë 03.06.2024

Gjyqtari
Florent Zeqiri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.